

DOKUMENTE E MATERIALE

VIÇENC STRATIGO

SHQIPTARI

"Atdheu lihet, braktiset; po nuk harrohet"
Nikolini.4)

Po botojmë për herë të parë në përkthimin shqip këtë vjershë të bukur, shumë pak të njohur edhe në origjinalin italisht, të poetit revolucionar me tendencë socialiste, Viçenc Stratigò. Një kopje të saj, të daktilogruar italisht, pati mirësinë të na e dhuroi i biri i poetit, plaku 88 vjeçar, Dr. Anxhelo Stratigò, kur i bëmë një vizitë në shtëpi, në nëndorin e vitit të kaluar, gjatë udhëtimit tonë për në Kosenxë, ku u mbajt kuvëndi për të përkujtuar 150 vjetorin e lindjes së De Radës. Dorëshkrimi në origjinal, sipas thëniesve të të birit të poetit, sot gjëndet në Akademinë Kozentine; ku janë dorëzuar e ruhen të gjitha dorëshkrimet e poetit. Vjersha; vetëm në tekstin italisht, është botuar në një broshurë me një tirazh në 500 kopje, ku flitet për kontributin që ka dhënë fshati arbëresh Lungro në luftat për çlirimin e bashkimit e Italisë më 1848, 1860. Kjo broshurë, me titullin "Parliamo di Lungro", nga që u botua në pak kopje, sot është shumë e rrallë. Kjo vjershë e bukur, me vrull tirtjejan, u shkrua më 1857, kur poeti arbëresh, Viçenc Stratigò ishte 35 vjeç. Ai që jetoi ngjarjet e mëdha të 1844 në Kalabri, ai që luftoi si udhëheqës ushtarak me të dyqind ungriotët në betejën e Kampotenezes kundra gjeneralëvev burbonë Lanca e Buzaka më 1848 për të përmbysur atë regjim të urryer, shkroi vjersha të fuqishme shqip e italisht për të nxitur arbëreshët në luftën çlirimtare garibaldine të 1859-60. Kjo vjershë, sipas thëniesve të të birit të poetit, Dr. Anxhelo Stratigò, u shpërnda në dorëshkrim nëpër fshatrat arbëreshe të Kalabrisë, ilegalisht. Më 16 korrik 1859, kur e gjithë Italia zien nga revolucioni, kur Garibaldi po përgatitesh të nisesh për Siqili e andej të hidhesh edhe në Kalabri, siç ndodhi me të vërtetë, në një meeting që u organizua në një shesh të Lungros, poeti që u foli fshatarëvev demonstrantë, u lexoi edhe këtë vjershë, e çila mbeti e harruar ndër dorëshkrimet e tij. Përmbajtja e fuqishme e kësaj vjershe i nxiti bashkëfshatarët e poetit për luftë dhe, që në atë meeting, dollën të pesëqind luftëtarët vullnetarë ungriotë, rrokën armët dhe, me të arritur Garibaldi në Kastrovillari, u bashkuan me të dhe e ndoqën gjer në Napoli. Të pesëqind ungriotët u organizuan në pesë kompani, njerën nga të cilat e udhëhoqi poeti luftëtar Viçenc Stratigò. Ai ishte edhe komisar politik i kompanisë.

Z. Kodra

1. T'rreptë kam shikimin, shpirtin të çiltër
Në gjoks më dridhet virtyt luftari,
Linda, do vdesi për vendin tim,
Shqiptar unë jam.
2. Princa t'guximshëm, idhnak'të poshtër
Ma shprishën gjakun, po jo kurrë zemrën,
Në shpirt-o paqën zoti ma derdhi,
Shqiptar unë jam.

3. Nga toka nënë t'Epirit t'ëmbël
Të mijt stërgjyshër ikën një ditë,
Nga vend i dashur duke qar'ikën,
Shqiptar unë jam.
4. Të zëmëruar nga fatkeqsia
T'etërvet pleq varret braktisën,
Mbi kodrat ngritën fshatin e bukur, 2)
Shqiptar unë jam.
5. Tej gjëmon qielli, ktu fërshllen era,
T'përsëris m'pëlqen një fjalë të dashur,
Kushtrim, kushtrim-o, ti vendi im,
Shqiptar unë jam.
6. O t'ëmbra ara, o kopshti im,
Dikur t'gzuar me detin afër,
O ltere t'shënjtë të vendit tim,
Shqiptar unë jam.
7. E shtrënjt'Italje, Italj'e bukur,
Ti më ke pritur tamam si motër,
Në gjin'e ëmbël të fshatit tim,
Shqiptar unë jam.
8. Fëmij dëgjova nga t'parët tanë
T'lashtat kurora t'luftravet tona,
Zemrim i shenjtë shpirtin ma ndezi,
Shqiptar unë jam.
9. Skënderi i im në luft' të shënjtë.
Me gjak të turkut tokën vaditi,
Dhe plot fitore në vend u kthye.,
Shqiptar unë jam.
10. Skënderi im që me vetimë t'syvet
Përpara vinte turqit me mijra,
Diell i shkëlqyer i vendit tim, 3)
Shqiptar unë jam.
11. N'vajtime linda, ndër arm'u rrita,
Me tinguj t'këngës përballoj vdekjen,
Në luftë do vdesi për vendin tim.,
Shqiptar unë jam.
12. Ttrashëgim tjetër unë nuk pata,
Zemër të dridhur, trimri të madhe,
M'tingllon në buzët një fjalë e ëmbël,
Shqiptar unë jam.
13. Në sy kam luftën, n'fytyrë kam vdekjen,
Po n'zemër mua më flet Parraisi,
M'tingllon në buzët një fjalë e ëmbël,
Shqiptar unë jam.
14. Besim i lashtë, dashuri e vendit
Ma ngroh mua gjoksin, ma ndez mua zemrën;
Gjakun e derdhi për vendin tim
Shqiptar unë jam
15. S'kam pasurira, përbuz paranë,
Rrëmbej unë shpatën t'Boçarit tim
T'Boçarit nami i vendit tim, 4)
Shqiptar unë jam.

16. N'dyzetetetën me zemrim t'shenjtë,
Kur mbreti ligjin-o na e shkeli,
Unë rrcka armët për vendin tim,⁵⁾
Shqiptar unë jam.
17. Vet unë mbi Kratin, n'kushtrim t'atdheut,⁶⁾
Vajta dhe ngula flamurin tim,
Shkunda dhe trimat e vendit tim,
Shqiptar unë jam.
18. Atje n'Sant Anxhelo, mbi kodrën rripë⁷⁾
Armikut t'mbarapsht ia prisha gjakun,
Kuror' fitoi atje fshati im,
Shqiptar unë jam.
19. Atje mbi sheshet e Kameratës
Me mijra mbretër un'i shkatrova,
Dhe un'i vetëm në vendin tim,
Shqiptar unë jam.
20. Na u ngrit Lungro, u ngrit Specano,
Akuafornoza me arm'në duar,
Armët rrëmbeu edhe Plataçi,
Shqiptar unë jam.
21. Shën Gjergji, Firmo, Shën Kostandini
N'kodrat luftuan të Shën Martinit,
Edhe Frasniti pas armvet rendi,
Shqiptar unë jam.
22. Edhe Shën Mitri, Makja krenare⁸⁾
Shpaloi në erë flamur'n e vet,
Armësh vetinte Kampotencze,⁹⁾
Shqiptar unë jam.
23. Atje n'luginën e Shën Martinit,¹⁰⁾
Trimrisht luftova, po qesh pa fat,
Mir'mbeç, o flamur i vendit tim,
Shqiptar unë jam.
24. O Kjud, ti Toç-o, Maur Kryelartë,¹¹⁾
Kokën u shtypën, jo kurr'mendimn,
O gjak i pastër i vendit tim,
Shqiptar unë jam.
25. Lul'e Greqisë, dashuri e lartë,¹²⁾
Nga ju mësohet se si të vdiset,
T'paharruar' emra të vendit tim,
Shqiptar unë jam.
26. Dhe ti Milano po vringllon shpatën,¹³⁾
Duke thirr' vetëm kundra të mbrapshtit:
— Vdis, ti, trian-o , i vendit tim,
Shqiptar unë jam.
27. I shënjt qëllimi, e shënjt' dëshira
Që digjet e ma ndez rryfe hyjnore,
Si rfe qëlloje armikn'n e vendit,
Shqiptar unë jam.
28. E ti frigacak m'dëgjon e qeshe,
Ti që më shkele të gjith'atdheun,
Ti je kopil-o i vendit tim,
Shqiptar unë jam.

29. Ti të atdheut shkele altarët,
Atdhen shpëtoj unë me gjakun tim,
Ik, se ty zoti, ty të mallkoi,
Shqiptar unë jam.
30. Ti nuk i shtyp dot me fuqin' tënde,
Virtytin tim-o, qendresën time,
Linda, do vdesi për vendin tim,
Shqiptar unë jam.
31. Ik i mallkuar, ik i mallkuar,
Se asnjë vend ty s'të mban në gji,
Ti je rebel-o i vendit tim, ⁴⁾
Shqiptar unë jam.
32. Kur ai Buzaka me shpirt të shitur ¹⁵⁾
Shpaloi drejt Lungros flamur'n e vet,
At'herë Skënderi n'zemër m'zbriti,
Shqiptar unë jam.
33. U ran'borivet ushtrit'e huaja,
Dhe un'i bija kambanës sime,
Ndër armë rendi tër'fshati im,
Shqiptar unë jam.
34. Nga thirrj'e lart'e dashurisë s'atdheut,
Me t'shept Buzaka tmerruar iku,
Si një pëllumb fluturimin mori,
Shqiptar unë jam.
35. Armik i kohës, armik i botës,
Vetëm virtyti më bën t'gzuar,
Flakroj shkëndia për vendin tim,
Shqiptar unë jam.
36. Në mes të armëvet mendimi m'lindi,
Në gjoks më dridhet guxim luftari,
Vajtoj për plagët e vendit tim.,
Shqiptar unë jam.
37. Ndër të panjohur bëj ball rrezikut,
Më mungon buka n'mërgim'n e rëndë,
E ëmbël vuajtja për vendin tim, ¹⁶⁾
Shqiptar unë jam.
38. Qëndroj paundur hekurash lidhur,
Vuaj, as shtrohem me kaqë mundime
Bir i vërtetë i vendit tim,
Shqiptar unë jam.
39. Luftoj për t'drejtën, t'shenjtën, t'vërtetën,
Po dëshroj ditën t'çlirimit tim,
Ngreu, o flamur i vendit tim,
Shqiptar unë jam.
40. Kushtrim, kushtrim-o, i shenjtë zemrimi,
Për fatkeqësinë zoti m'frymzon,
Ndër armë, ndër armë, o vendi im.,
Shqiptar unë jam.

Përktheu nga origjinali italisht:

ZIAUDIN KODRA

1) Me këtë citat poeti vret tek Shqipëria. Arbëreshët edhe sot e quajnë Shqipërinë atdhe të lashtë; ata edhe sot e kësaj dite janë krenarë për origjinën e tyre shqiptare. Këtë notë poeti e ka shprehur bukur në të gjithë vjershën.

2) Një numur i madh fshatrash arbëreshe të Kalabrisë janë ndërtuar në pozicione shumë të bukura mbi kodrina dhe shikojnë detin Jon. Në një pozicion të tillë të bukur, është ndërtuar edhe fshati i poetit, Lungro.

3) Arbëreshët edhe sot janë krenarë për të kaluarën e tyre, kohën e Skënderbeut. Kujtimi i tij ruhet i gjallë nëpër festat dhe nëpër emrat e rrugëve të fshatit. S'ka fshat arbëresh ku të mos gesh në një rrugë emrin e heroit të Krujës. Sheshi më i bukur i Lungros mbante emrin e Skënderbeut; edhe monumentin e luftëtarëve të fshatit ungriotët e kishin venë në këtë shesh.

4) Si e kemi konstatuar me sytë tona, nëpër fshatrat arbëreshe, ruhet me krenari kujtimi i luftëtarëve me origjinë shqiptare për çlirimin e Greqisë. Në Shën Mitër pamë rrugë e sheshe të fshatit me emrat e Boçarit e Xhavellës.

5) Më 29 janar 1848, Ferdinandi i II, nga presioni i masave që ishin ngritur në barikada në rrugët e Napolit, shpalli kushtetutën. Po e tërhoqi më 15 maj 1848-tës. Plasi revolucionari; ku mori pjesë edhe poeti.

6) Krati është lumi i Kalabrisë, që del nga malet e Silës dhe derdhet në detin Jon.

7) Vend ku u ndeshën forcat me armikun.

8) Lungro, Spezzano, Acquafredda, Plataçi, San Giorgio, San Costantino, Frascineto; San Demetrio, Macchia, janë fshatra arbëreshe që morën pjesë në revolucionin e 1848-tës. U dalluan sidomos Lungro dhe San Demetrio.

9) Luginë e Kalabrisë ku u zhvillua beteja në mes të forcave burbone dhe kryengritëse të Kalabrisë. Në betejën e Campotenese u thyen forcat lirishtetëse, ku luftoi edhe poeti.

10) Vend betejë.

11) Demetrio Chiodi, Vincenzo Mauro nga Shën Mitri dhe Francesco Tocci nga San Cosmo Albanese janë tre nga martirët e shumë arbëreshë që ranë për çështjen e çlirimit dhe të bashkimit të Italisë. Kur dy gjeneralët burbonë me forcat e tyre janë, njëri në Castrovillari dhe tjetri në Rotonda dhe po pregatiten të dy të rrethojnë forcat revolucionare në Campotenese, këta tre të rinj, Chiodi, Tocci e Mauro, vendosin të venë edhe të vrasin gjeneralin Lanza në Rotonda. I tradhëtoi, duke i paditur, një fshatar nga Rotonda. U kapën me armë në duar, i lidhën dhe si u vranë nga ushtarë burbonë, i tërhoqën për këmbësh zvarrë nëpër rrugët e fshatit Rotonda, duke i shtypur barbarisht edhe kokët, po ideja e tyre mbeti e gjallë, si thotë poeti.

12) Poeti që kishte marrë një kulturë të shëndoshë klasike në kolegjin e Shën Adrianit në Shën Mitër, është adhuronjës i Greqisë së lashtë, prandaj i krahason martirët me lulen e trimërisë së Greqisë së lashtë.

13) Tjetër hero legjendar arbëresh, që më 8 dhjetor 1856 qëllloi me bajonetë mbretin Ferdinand në Napoli. Pas pak ditësh u var në mes të Napolit.

14) Në strofat 28, 29, 30, 31 poeti vret tek mbreti Ferdinand, që sundon me dhunë.

15) Gjeneral Busacca, që theu forcat revolucionare në Campotenese.

16) Historianë të kohës kanë përshkruar me nota ngjethëse vuajtjet e të denuarvet politikë, shumë herë edhe për bukë, në mes të të cilëve edhe shumë arbëreshë. Më e tmershme që masa që mori Ferdinandi për t'i dëgdisur nëpër vendet e Amerikës latine.

